



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT

<b>Drejtoria</b>	<b>Drejtoria e Shëndetësisë</b>
<b>Periudha Raportuese</b>	<b>Maj, 2021</b>
<b>Emri dhe mbiemri i raportuesit</b>	Dr. Fatlinda Hoxha – zyrtare për shëndetësi – DSH, Dr. Hajrullah Fejza – shef i Sektorit të shëndetësisë në DSH

#### 1. PËRMBLEDHJE

2. Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes, ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Gjatë muajit maj 2021, Drejtoria e Shëndetësisë pranoi lëndë të kategorive të ndryshme. Stafi në këtë drejtori kishte takime të përditshme me qytetarë për t'u njoftuar me procedura dhe me shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

#### 3. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj:

- Renovime dhe përmirësime të infrastrukturës në objekte shëndetësore;
- Furnizime të ndryshme bazuar në kontratat aktive;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;
- Inicimi i përgatitjeve administrative, zbatimi i planit të prokurimit 2021;
- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të drejtorisë.

#### 4. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër.

Theksoni të arriturat e drejtorisë:

Gjatë muajit prill 2021, u realizuan aktivitete të rëndësishme dhe përgjegjësi të planifikuara për periudhën raportuese:

- Identifikim dhe përgatitje e specifikave për procedurë prokurimi;
- Përpilim i specifikave:
  - Furnizim me uniforma për personelin shëndetësor,
  - Furnizim me pajisje mjekësore për institucionet në KPSH,
  - Furnizim me material shpenzues mjekësor;
- Njoftim për kontratë:
  - Deratizimi, dezinfektimi dhe dezinfektimi në objektet shëndetësore,
  - Furnizimi emergjent me teste serologjike -SARS-COV 2,
  - Furnizim emergjent me insulina për nevojat e QKMF-së,
  - Furnizim me material shpenzues mjekësor,
  - Furnizim me material shpenzues për shërbime laboratorike- Furnizim me reagensa për numërues hematologjik ADVIA 560 5 - Loto 3;
- Njoftim për dhënien e kontratës:
  - Furnizimi me material administrativ shëndetësor;
- Monitorimi i mbarëvajtjes së përditshmërisë të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU dhe aktivitetet:
  - Renovimi dhe përmirësimi i infrastrukturës së institucioneve publike në KPSH,
  - Furnizimi dhe montimi i inventarit në institucionet publike në KPSH;
- Gjatë periudhës raportuese vazhduan punimet në përmirësim të infrastrukturës dhe inventarizimi në:
  - QMF 5,
  - QMF 4,
  - AMF Bardhosh;
- Takime të vazhdueshme me menaxhmentin e QKMF-së dhe QMU-së në lidhje me përditshmërinë e punës me qytetarë;
- Asistencë gjatë përgatitjes së sallës “1 Tetori” për fillimin e vaksinimit kundër virusit COVID-19;
- Mbatja e takimeve të përditshme me drejtorin e DSH-së, si dhe mbajtja e takimeve javore me drejtorin e QKMF-së dhe QMU-së;
- Vëzhgimi i punës në bazë ditore për ecurinë e dhënies së terapisë parenterale, si dhe testeve antigjene në QMF VII në lagjen “Emshir”;
- Përgatitje teknike dhe administrative mbi hapjen e konkursit publik për plotësimin e vendeve të lira me profesionistë shëndetësorë;
- Raport - Performanca komunale MAPL;

- Raport – Performanca komunale – Zyra e personelit, Zyra për të drejta njerëzore dhe barazi gjinore.

## 5. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Përgatitja e specifikave bazuar në planin e prokurimit 2021;
- Mbikëqyrje të vazhdueshme të punës së përditshme të personelit shëndetësor në objektet shëndetësore rreth mbarëvajtjes së punës;
- Përgatitje teknike rreth vlerësimit të lëndëve rreth subvencioneve – shëndetësore.

## 6. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj.

Shtoni kategoritë sipas nevojës.

### 6.1.1. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese

Fondi burimor	Planifikuara	Alokuara	Shpenzuara	Nr. lëndëve
Pagat	<b>7,570,000</b>	<b>3,528,338.52</b>	<b>610,723.58</b>	
Mallra dhe shërbime				
10	1,294,300.00	647,150.02	103,260.64	10
21	400,000.00	103,342.50	3,192.11	5
4	771,740.00	771,740.00	49,830.57	79
Komunali				
	300,000.00	67,635.35	22,460.84	35
Kapitale				
21	1,600,000.00	750,000.00	36,161.95	1
22	1,211,377.00		17,185.30	3
Subvencione				
	150,000	150,000.00	33,630.00	176

Raport - deklarim i borxheve më të vjetra së 30 ditë;

Deklarimi për ATK-në;

Raport mujor, shpenzimet e realizuara dhe për të hyrat nga bashkëpagesat për shërbime shëndetësore;

Pranim të faturave dhe arkivimi i tyre;

Përgatitja e dokumenteve të nevojshme për procedim të mëtutjeshëm;

Zotimi;

Dërgimi i lëndëve për procedim të mëtutjeshëm në prokurim dhe financa;

Përgatitja e deklaratave të disponueshmërisë për procedura të prokurimit;

Më 26.05.2021, kemi mbajtur komision për shqyrtimin e kërkesave dhe trajtim mjekësor;

\* Shqyrtuar gjithsej 112 kërkesa;

\* Të miratuara 109 kërkesa;

\* Refuzim 3 kërkesa -aplikim 2 herë;

\* Përgatitja e lëndëve për procedim të pagesave;

#### **6.1.2. Takimet me palë;**

- Çdo ditë nga 9:00-15:00, DSH bën pranimin e palëve.

#### **6.1.3. Takimet me institucione tjera;**

- Drejtoria e Investimeve Kapitale:
  - o Menaxhim i kontratës "Renovime dhe rindërtime";
- Drejtoria e Prokurimit:
  - o Procedura rreth kontratave të ndryshme;
- Drejtoria e Urbanizmit:
  - o Kushte ndërtimore- Projekte arkitektonike QMF "Prishtina e Re"
  - o Zona Perëndim;
- Drejtoria e Inspektionit:
  - o Njoftim rreth fillimit të përmirësimit të infrastrukturës në AMF Bardhosh;

#### **6.1.4. Diskutime publike, takime me qytetarë;**

#### **6.1.5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare;**

#### **6.1.6. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër;**

- pranuar gjithsej 114 lëndë, prej tyre 96 i përkasin trajtimeve mjekësore, ndërsa 18 prej këtyre kërkesave i përkasin kategorive të ndryshme.

### 6.1.7. Përfitues të subvencioneve:

Me 26.05.2021, u shqyrtuan gjithsej 112 kërkesa, nga të cilat u miratuan 99.

### 6.1.8. Takime të tjera

Drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë, dr. Bujar Gashi, më qëllim të mbarëvajtjes së punës në Sektorin e shëndetësisë, në mënyrë të vazhdueshme ka realizuar takime me përfaqësuesit e QKMF-së dhe QMF-së.

Në këto takime drejtori Gashi ka biseduar edhe për vështirësitë që kanë QKMF-të dhe njësitë e saj dhe QMU, sa i përket përballjes me situatën e krijuar më COVID-19, dhe gjetjen e alternativave për të përballuar sa më mirë këtë situatë nga stafi shëndetësor. Një çështje më rëndësi sa i përket Sektorit të shëndetësisë në Komunën e Prishtinës, ka të bëjë edhe me vaksinimin kundër virusi COVID-19, ku ka realizuar takime me grupe punuese së bashku me drejtuesit e Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me ecurinë e këtij procesi të rëndësishëm.

## 7. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë:

- Mungesa e stafit në DSH;
- Numri jo i mjaftueshëm i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;
- Buxhet jo i mjaftueshëm, sidomos për kategorinë "Mallra dhe shërbime", ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve, rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

## 8. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHEN PASUESE

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve bazuar në planin e prokurimit;
- Monitorim i përditshmërisë së personelit për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme;

## 9. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

## QENDRA E MJEKËSISË URGJENTE:

Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë, gjatë muajit prill 2021, punoi bazuar në situatën e pandemisë me COVID-19, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore urgjente për qytetarët e Komunës së Prishtinës.

Patologjia dhe shërbimet.

Rastet urgjente janë trajtuar sipas prioriteteve të tyre:

- Hipertension arterial;
- Bronchit acute;
- Gjendjet febrile të dyshimta për COVID-19;
- Reaksionet alergjike akute;
- Asthma bronchiale;
- Ulcera gastroduodenale;
- Cholelcistitet akute dhe kronike;
- Gjendjet depressive;
- Sëmundjet malinje;
- Syndrome lumbago;
- Aksidentet e trafikut;
- Lëndimet etj.

### **Edukimi i vazhdueshëm profesional (EVM)**

Në kuadër të "Edukimit të vazhdueshëm mjekësor", më 28.04.2021, nga ora 13:00 deri ne orën 15:00, me formën online, përmes platformës "Zoom" është mbajtur ligjërata me temën: "Synkopa, shkaqet, tretmani dhe kujdesi në kushte paraspiatore".

### **Furnizimi me medikamente dhe material sanitar**

Furnizimi vazhdoi nga Ministria e Shëndetësisë - Divizioni Farmaceutik dhe nga kompanitë e kontraktuara prej Drejtorisë së Shëndetësisë;

Furnizimi me mjete mbrojtëse (veshje mbrojtëse, maska, doreza, kalaqe, syze) kundër COVID -19, janë plotësuar nevojat për stafin mjekësor;

Njëkohësisht me kërkesë të Divizionit Farmaceutik të MSH-së, zyrtarja e farmacisë ka dorëzuar planin 6 mujor për furnizim me pajisje mbrojtëse për stafin shëndetësor.

### **Situata me pandeminë COVID-19**

QMU nëpërmes linjës tel.194, vazhdon të ofroj këshilla për qytetarë se si të mbrohen dhe si të veprojnë kur dyshojnë në infeksion me COVID-19;

Duke përcjell situatën epidemiologjike me pandeminë, kemi një situatë më të volitshme sa i përket pandemisë, sidomos nga pjesa e dytë e muajit prill;

Gjatë këtij muaj, ishin dy punëtor të infektuar me COVID -19;

Ndërsa në sallën "1 Tetori", rreth 80% të punëtorëve shëndetësorë nga QMU-ja, janë vaksinuar me dozën e parë të Astra -Zeneca;

Sipas programit, pritet që në muajin qershor stafi shëndetësor të marrë edhe dozën e dytë të vaksinës, dhe në këtë mënyrë shpresojmë se do të kemi një mbrojtje solide nga pandemia COVID-19;

Nga data 29.03 deri me 22.04.2021, një ekip mjekësor nga QMU-ja, ka kujdestaruar në sallën "1 Tetori", për të ofruar kujdes mjekësor për të gjithë personat të cilët i janë nënshtruar vaksinimit me dozën e parë;

Fatmirësisht, përveç nevojës për ndonjë këshillë ose ndonjë ekzaminim, si matje të shtypjes së gjakut, saturimit të oksigjenit, matjes së sheqerit etj., raste me efekte të padëshirueshme nga vaksina nuk janë raportuar nga ekipet mjekësore.

### **Nga aktivitet kulturo- sportive**

Një ekip mjekësor asistoi me ambulancë në ndeshjen finale të kupës së futcallit të Kosovës, më 14.04.2021, nga ora 16:45 deri 19:45.

### **Shërbimet shëndetësore**

Nr.	Lloji i shërbimit	Nr.
1	Vizita mjekësore në terren	1362
2	Vizita mjekësore në QMU	10
3	Aksidentet trafiku	84
4	Fatkeqësitë në punë	3
5	Fatkeqësitë të tjera	41
6	EKG	4
7	Konstatim vdekjeje	57
Gjithsej		1808

### **ZYRA E PROKURIMIT NË QMU RAPORT PËR MUAJIN PRILL 2021**

#### **❖ AKTIVITETET E PLANIFIKUARA:**

- Zhvillimi i aktiviteteve të procedurave të prokurimit sipas prioriteteve dhe kërkesave nga njësitë kërkuuese;
- Bashkëpunimi i Zyrës së prokurimit për kontratat e lidhura në Komunë dhe bashkëpunimi sipas UA, 2016 të LPP me AQP për kycje në kontratat e centralizuara;
- Sipas LPB-së, bashkëpunimi me drejtorin e QMU-së për caktimin e komisioneve dhe punimin e vendimeve, nënshkrimi dhe protokollimi për vlerësimin e ofertave dhe pranim të mallrave, shërbimeve dhe caktimin e menaxherëve të kontratave etj;
- Sipas nevojave të paraqitura.

#### **❖ AKTIVITETET E ZBATUARA:**

- Furnizim me material shpenzues, zyrtar-nivel lokal-Loto IV, me nr. AQP 19 008 111, e datës 10.06.2020, nga kontrata e centralizuar nga AQP, caktimi i komisionit për pranim, kompletimi i lëndës, fotokopjimi dhe dorëzimi i saj në financa për zotim të mjeteve;
- Nxjerrja e urdhër blerjeve në sistemin e FREE BALANCIT për të gjitha faturat për kontratat që lidhen në QMU dhe faturat e kontratave të AQP-së të cilat i shfrytëzon QMU-ja;

- Pas pranimit të kërkesës për furnizim me material për laborator, kam punuar dosjen e tenderit, shpërndarja e dosjes tek operatorët ekonomikë, pranimi i ofertave, hapja e tyre, vlerësimi, shpërblimi i OE-së me kontratë dhe njoftimi përmes letrës standarde, punimi dhe lidhja e kontratës dhe nënshkrimi i saj. Përgatitja e njoftimit për nënshkrim kontrate dhe dërgimi i saj në KRPP, sipas rregullave dhe ligjit të PPK-së, furnizimi me material, caktimi i komisionit për pranim, pranimi i faturës dhe dokumentet tjera përcjellës.

❖ **AKTIVITETET NË ZBATIM E SIPËR**

- ❖ Takime me palë të ndryshme, kompletimi i lëndëve për pagesa dhe aktivitete tjera sipas nevojës.

**ZYRA E FINANCAVE NË QMU**

**RAPORT MUJOR (muaji prill, 2021)**

❖ **AKTIVITETET E PLANIFIKUARA**

- ❖ Mbajtja e një takimi me stafin udhëheqës në lidhje me pagesën e ndërrimeve të natës.

❖ **AKTIVITETE TE PËRFUNDUARA:**

Përgatitja e lëndëve të dhëna në vazhdim për pagesë dhe fotokopjimi i tyre:

- Shpenzimet e telefonit, shuma 35.21, € për muajin mars;
- Shpenzimet e tel. në rr. "Xhemail Ibishi"- 6.99, € muajin mars;
- Shpenzimet e ngrohjes për muajin mars - 1,589.59, €;
- Mbushje telefonike për punëtorë - 299.37, € mars;
- Furnizim me ujë për pije - 40.00, € mars;
- Shfrytëzimi i automjetit me qira - 347.00, € prill;
- Furnizim me karburante - 1,631.38, € mars;
- Furnizim me material zyrtar - 89.00, € ;
- Përgatitja e 9 faturave për mirëmbajtjen e autoambulancave, shuma - 3,459.20, €;
- Shtesat e pakos emergjente, prill -18,050.00, €;
- Ndërrimet e natës, mars - 11,354.52, €;
- Përcjellja e pagave me ndryshime – pushime të lehonisë, largime nga puna etj.;
- Përgatitja e pagave për 6 punëtorët me kontrata për punë specifike për muajin mars.

❖ **AKTIVITETE NË ZBATIM E SIPËR:**

- ❖ Faturat të cilat duhet të përgatiten për pagesë;
- ❖ Fatura e rrymës, shuma, sigurimi i autoambulancave;
- ❖ Mirëmbajtja e fotokopjes dhe printerëve;
- ❖ Mbushje për punëtorë për muajin maj;
- ❖ Përgatitja e ndërrimeve për muajin prill, pasi të vjen lista nga kryeinfermieri i bashkëngjitet pagave të majit;
- ❖ Përgatitja e pakos emergjente për muajin maj;



- ❖ Përgatitja e faturave komunale (rrymë ngrohje, PTK) të cilat janë të rregullta, së bashku me faturat e karburanteve dhe automjetit me qira, si pagesat dhe shërbimet tjera;
- ❖ Kontrollimi i arkës dhe mbarëvajtje e parasë së imët.

## **QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE**

### **RRJEDHA E PUNËS**

- Ka vazhduar organizimi i brendshëm i përshtatur me situatën epidemiologjike, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore:
  - Tri Qendra të Mjekësisë Familjare (QKMF, QMF IV dhe QMF V) kanë vazhduar punën pa ndërprerje (24/7) në ndërrime të zakonshme (07:00 deri në orën 13:30; 13:30 deri në orën 20:00 dhe 19:00 deri në 07:00).
  - Të gjitha QMF-të punuan me orar të rregullt (07:00 deri në 13:30, 13:30 deri në 20:00);
  - Në QMF-të kujdestaria e rregullt mujore, e shtunë (07:00 deri në 19:00) dhe e diele (07:00 deri në 13:00);
  - QMF 7 "Emshir" nga data 19.05.2021 ka filluar punën me orar të rregullt (07:00 deri në orën 13:30, 13:30 deri në orën 20:00), po ashtu organizohet kujdestaria e rregullt mujore, e shtunë (07:00 deri në orën 19:00) dhe e diel (07:00 deri në orën 13:00);
  - Ndërkohë në QMF 7 ka vazhduar të ofrohet edhe testi rapid antigjenik për qytetarët e Prishtinës, ku janë punuar 1484 teste, ndërsa në QKMF edhe analiza e D-dimerit, ku janë punuar 1447 D-dimera, që të dyja këto falas, po ashtu janë punuar edhe testet serologjike, 236 teste.
  - Numri i pacientëve më COVID-19 pozitiv që kanë kërkuar trajtim parenteral në QMF 7, është 1155, është mundësuar dhënia e terapisë parenterale nëpër qendrat tjera, aty ku hapësirat janë të përshtatshme për kryerjen e këtij shërbimi;
  - Numri i përgjithshëm i pacientëve më terapi parenterale në qendrat tjera ka arritur shifrën në 1044 ;
  - Numri i përgjithshëm i konsultave virtuale gjatë muajit maj 312 konsulta;
  - QMF Besi, orari i punës (07:00 deri në orën 13:30 13:30 deri në orën 20:00 ) organizohet dhe kujdestaria e rregullt mujore, e shtunë (07:00 deri në 19:00) dhe e diel (07:00deri në orën 13:00),AMF Bardhosh nga data 05.05.2021, është në renovim, AMF Barilevë, nuk punon, AMF-së Sharban dhe Rimanishtë orari i punës (07:00deri në orën 14:00);
  - AMF Llukar, orari i punës( 07:00 deri në 14:00), AMF Keqekollë, orari i punës(08:00 deri në 14:00) të martën nuk punohet, AMF Koliq, punohet të martën nga ora (08:00 deri në 14:00), AMF Dabishevc, punohet të enjten nga ora (10:00 deri në 12:00);

- AMF Mramor, orari i punës (07:00 deri në 13:30) çdo ditë, AMF Slivovë, Viti, Bullaj nuk punohet, AMF Kishnicë, orari i punës (07:00 deri në 13:30);
- AMF Shkabaj, orari i punës (07:00 deri në 13:30);
- Poliklinika e Stomatologjisë dhe shërbimi stomatologjik, orari i punës (07:00 deri në 15:00), shërbimi i stomatologjisë në QMF 5 punon 24/7;
- Shërbimi pediatrik, orari i punës (07:00 deri në 13:30 dhe 13:30 deri në 20:00);
- QMG, orari i punës (07:00 deri në 15:00);
- Shërbimi specialistik, orari i punës (07:00 deri në 15:00);
- Mjekësia e punës, orari i punës (07:00 deri në 15:00);
- DAT, orari i punës (07:00 deri në 13:00);
- Laboratori qendror, orari i punës (07:00 deri në 14:00 -13:00 deri në 20:00);
- Radiologjia, orari i punës (07:00 deri në 13:00), tri njësi radiologjike në QKMF, QMF4, QMF 5;
- Shërbimi i vaksinimit, orari i punës (08:00 deri në orën 16:00), orari është përshtatur për arsye pjesa më e madhe e punëtorëve shëndetësorë nga data 29.03.2021, janë duke kontribuar në sallën "1 Tetori" rreth vaksinimit të qytetarëve kundër
- COVID-19 ;
- Gjatë kësaj periudhe kohore janë vaksinuar gjithsej: 13.580 qytetarë;
- Në sallën "1 Tetori", gjinden 7 ekipe (një mjekë dhe dy infermiere) orari i punës (08:00 deri në orën 13:30, 13:30 deri në orën 19:30) punohet edhe gjatë vikendeve;
- Numri i stafit të infektuar gjatë muajit maj është 1 person;

Gjatë vizitave monitoruese në të gjitha qendrat e mjekësisë familjare (ndërrimi i paradites, pasdites dhe ndërrimi i natës) nuk janë konstatuar mangësi serioze.

- Respektohen rregullat e përgjithshme, furnizimi qëndron mirë, masat mbrojtëse aplikohen.

Vizita mjekësore	Shërbimet shëndetësore	Shërbimet laboratorike	Shërbimet stomatologjike	Shërbimet radiologjike	Gjithsej
68765	66330	58956	10300	2217	206568